



Pranuar / Dorezuar Punëhene/Prodate Received/Doitveqy	31.08.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Hi Prot Br Prot Prot No	Shtesa Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHOK	5904	2023	118



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1008/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1008/2023 të datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesja , me adresë rruga , N. 13/7, Nr. 23 në Prishtinë, kundër Vendimit KA.nr.19/2023 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1008/2023 e datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.19/2022 i datës 22.06.2023 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- III. Anulohet Njoftimi për kandidatët e suksesshëm i datës 01.06.2023 për pozitën *Referent 6-pozita në Gjykatën Komerciale*, faza e testimi me gojë dhe me shkrim si dhe Raporti i përgatitjes së listës së ngushtë.
- IV. Obligohet Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të ndërmarr veprimet e nevojshme që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të zhvilloj procedurën e rekrutimit për pozitën *Referent 6- pozita në Gjykatën Komerciale*, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.

V. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të kujdeset që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën IV të dispozitivit.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 15.02.2023 ka shpallur konkursin me Nr. 01/2023 për pozitën "Referent 6- pozita në Gjykatën Komerciale", në të cilin ka aplikuar edhe ankuesja, e cila është përfshirë në listën e shkurtër dhe në fazën e testimit me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës më datë 01.06.2023 është publikuar njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare, ku në bazë të këtij njoftimi rezulton se ankuesja nuk është kandidatë e suksesshme, ngase sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesja ka rezultuar me 280 pikë duke u renditur e 39 në listën përfundimtare.

Ankuesja kundër vlerësimit të rezultatit përfundimtar, më datë 14.06.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 22.06.2023 ka nxjerr Vendim KA.nr.19/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi listën e kandidatëve të suksesshëm të datës 01.06.2023.

Ankuesi, kundër Vendimit KA.nr.19/2023 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes postës më datë 17.07.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 19.07.2023 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1008/2023 me numër protokollit 5299/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, 24.07.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 01.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5299/2023 të datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.19/2023 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Dëftesë për pranimin e dërgesës i datës 08.06.2023; Ankesën e ankueses e parashtruar për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Shkresë nga ankuesja për Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Zyrës për Komunitet në Zyrën e Kryeministri, Kryetarit e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kryetarë për të Drejtat e Njeriut dhe Personat e Zhdukur në Kuvendin e Kosovës;

Zarfin e datës 17.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 01.08.2023; Udhëzuesin për testin me shkrim i datës 29.04.2023; Testin me shkrim të ankueses; Kërkesën për punësim të ankesës e datës 28.02.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.02.2023, Diplomën me Nr. 4211, Certifikatën e Diplomimit e datës 30.08.2021, certifikatën nga NDI, Certifikatën Nr. 102/09, Referencën e datës 27.02.2023, Referencën e datës 10.01.2023, Kontratë Punë e datës 09.10.2021, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.08.2022 deri 22.02.2023, Akt Emërimit e datës 17.12.2015, Dokument identifikimi i ankueses; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare i datës 01.06.2023; Propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar i datës 01.06.2023; Raporti Final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 01.60.2023; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 01.06.2023; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Formulari për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë i datës 13.04.2023; Njoftimin për testim me shkrim i datës 26.04.2023; Raportin mbi përgatitjen e listës së ngushtë; Konkursin me Nr. 01/2023 të datës 15.02.2023; Testin me shkrim të kandidatës T.D; Kërkesën për punësim të kandidatës T.D e datës 02.03.2023, Kontratë Shërbimit e datës 23.09.2021, Kontratë Pune e datës 27.07.2022, Marrëveshje për punë praktike e datës 16.09.2022, Kontratë për punë praktike vullunetere e datës 01.03.2019, Letër rekomandimi, Diplomën me Nr. 2504, Diplomën me Nr. 475, Certifikatën e darës 20.05.2017, Certifikatën e datës 06.10.2017, certifikatën e datës 26.05.2017, Certifikatën e datës 15.05.2018, Certifikatën e datës 31.05.2021, Certifikatën e datës 28.01.2020, Certifikatën janar 2018, Certifikatën nëntor 2020 deri shkurt 2021, Certifikatën mars-qershor 2021, Certifikatën nëntor 2020, Certifikatën tetor/nëntor 2017, Dokument identifikimi për kandidaten T.D, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 20.02.2023, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 11.03.2021 deri 23.02.2023; Testin me shkrim të kandidatës K.K, Kërkesën për punësim të kandidatës K.K të datës 28.02.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 28.02.2023, Dokument identifikimi për kandidaten K.K, Diplomën me Nr.5008, Certifikatën e datës 12.02.2019, Certifikatën e datës 30.12.2019, Kontratë e Shërbimeve mes kandidatës K..K dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Letër Rekomandimi e datës 23.09.2019, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 16.05.2019 deri 23.02.2023, Referencë e datës 17.09.2019, Rekomandimin e datës 12.02.2019, 20.06.2019, Letër reference e datës 05.01.2023, Marrëveshje për angazhim në praktike pune e datës 05.10.2022, 05.04.2022; Testin me shkrim të kandidatit G.S, Kërkesën për punësim të kandidatit G.S e datës 27.02.2023, Diplomën me Nr. 3248, Vërtetimin e datës 22.02.2023, Vërtetimin e datës 28.01.2020, Certifikatën e datës 15.05.2017, Referencën e datës 01.03.2017, Referencën e datës 21.12.2020, Dokument identifikimi për kandidatin G.S, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 20.02.2023; Testin me shkrim të kandidatës E.G, Kërkesën për punësim e datës 01.03.2023 e kandidatës E.G, Certifikatën e datës 07.09.2022, Certifikatën e datës 18.02.2022, Letër referencë e datës 22.02.2022, Letër reference e datës 11.03.2021, Certifikatën e datës 25.04.2018, Vërtetimin e datës 01.03.2023, Kontrate për punë për kohë të caktuar e datës 01.03.2022, Certifikatën e datës 01.05.2021, 18.05.2022, Dokument identifikimi për kandidaten E.G, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.02.2023; Testin me shkrim për kandidaten B.B-V, Kërkesën për punësim e datës 24.02.2023 për kandidate B.B-V, Diplomën me Nr. 172, Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 01.09.2022, Kontratë punë e datës 01.07.2020, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 25.02.2011 deri 20.02.2023, Certifikatë e datës 09.01.2018, Referencë, e datës

12.02.2018, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.02.2023, Dokument identifikimi për kandidaten B.B-V; Testin me shkrim të kandidatit R.H, Kërkesën për punësim e datës 03.03.2023 për kandidatin R.H, Diplomën me Nr. 6259, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 01.03.2023, Dokument identifikimi për kandidatin R.H, Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 21.07.2022, 10.10.2022, 13.09.2022, 11.11.2022, Kontrate për punë të praktikës profesionale e datës 19.11.2020, Vërtetim i datës 09.07.2020, 24.10.2019, Referencën e datës 16.07.2020, 26.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është pjesërisht e bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.19/2023 të datës 22.06.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pretendon se janë shkelur parimet e pranimit të zyrtarëve publikë sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ngase nuk i është dhënë mundësia për punësim si komunitet jo shumicë ngase në mesin e kandidatëve të përzgjedhur nuk është asnjë nga komunitetet jo shumicë; Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka vendosur në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Në bazë të konkursit me Nr. 01/2023 për pozitën *Referent 6-gjashtë pozita* në Gjykatën Komerciale të shpallur më datë 15.02.2023 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, , kriteret kanë qenë të përcaktuar "*Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë; Fakulteti Juridik dhe Së paku dy (2) vite përvojë pune*".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "*Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjedhjen e çështjes administrative*", do të bëjë shqyrtimin në tersi të procedurës për pozitën *Referent 6-gjashtë pozita* në Gjykatën Komerciale.

Gjykata Kushtetues e Republikës së Kosovës në Aktgjykimin për rastin Nr. KO 203/19 të datës 09.07.2020, ka theksuar që Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet për nëpunësit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës sepse cenohet pavarësia e një institucioni të pavarur kushtetues, më konkretisht neni 115 i këtij aktgjykimi përcakton se: "*duke pasur parasysh që Gjykata sapo ka konstatuar shkelje të Ligjit të kontestuar në raport me nëpunësit e KGJK-së dhe KPK-së por nuk ka anuluar zbatimin e Ligjit të kontestuar në raport me institucionet e tjera lidhur me të cilat nuk është kontestuar kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar, Kuvendi i Kosovës duhet, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të kontestuar në harmoni me gjetjet e këtij Aktgjykimi, në mënyrë që të njeh të drejtën e KGJK-së dhe KPK-së për nxjerrjen dhe aplikimin e rregullave të tyre të brendshme, sa i përket, inter alia, çështjeve të strukturës organizative të*

funksionimit; klasifikimit të pozitive; kushteve të veçanta për rekrutim; orarit të punës; si dhe të drejtave dhe detyrimeve specifike të përcaktuara me Ligjin e kontestuar, ashtu si parashihet për nëpunësit e Kuvendit sipas nenit 4 [Nëpunësit civilë me status të veçantë], paragrafi 3 dhe 4, ku Kryesia e Kuvendit ka të drejtë të nxjerrë akte nënligjore për të rregulluar çështje të caktuara të nëpunësve të saj civilë". Po ashtu duke pasur parasysh që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me këtë aktgjykim ka shfuqizuar nenin 85 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nënkupton që Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ende është i zbatueshëm për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe institucionet e tjera kushtetuese të specifikuar në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kështu që kjo procedurë është zhvilluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Bazuar në shqyrtimin e tërësishëm të kësaj procedure, si dhe gjatë analizimit të dosjeve të kandidatëve të përzgjedhur dhe ankueses të dërguar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja me rastin e aplikimit për këtë pozitë ka dërguar dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit e që në bazë të tyre rezulton se për nga përgatitja profesionale posedon Diplomën me Nr. 4211 të datës 11.10.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se më datë 09.11.2013 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marr titullin *Jurist i Diplomuar-Bachelor*, ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta ka dorëzuar Akt Emërimit e datës 17.12.2015 përmes të cilët dëshmohet se ka qenë e punësuar si Praktikant Vullnetar në Gjykatën Themelore në Gjakovë për një periudhë një (1) vjeçare, sipas Kontratës së Punës e njëjta nga data 09.10.2021 deri më datë 31.01.2022 ka qenë në marrëdhënie pune në OJQ "Aplikimi i Demokracisë në Kosovës", në pozitën Menaxhere e Projektit, sipas Referencës së datës 10.01.2023 të lëshuar nga "Roma Versitas Kosovo" e njëjta ka qenë e angazhuar si juriste për periudhën Qershor-Shtator 2022, po ashtu ankuesja me rastin e aplikimit ka dorëzuar pasqyrën e llogarisë nga Trusti për një përuddhë prej 01.08.2002 deri më datë 22.02.2023. Nga këto dëshmi të dërguara rezulton se ankuesja nuk ka ofruar vërtetime të marrëdhënies së punës e të cilat do të dëshmonin se e njëjta ka dy vite përvojë pune siç kërkohet me konkurs për shkak se me rastin e aplikimit kandidatët duhet të dërgojnë edhe kopjet e dëshmisë së punësimit siç parashihet me nenin 21 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të bashkangjitura në aplikacion, kopjet e dëshmisë së punësimit (për kandidatët të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil)...", si rrjedhojë edhe pse ankuesja ka dërguar dëshmi nga kursimet pensionale të njëjtën nuk i ka bashkangjitur edhe provat mbështetëse të cilat do të dëshmonin përvojën e punës, ngasë përvoja e punës duhet të dëshmohet me kontratë pune ndërsa vërtetimi i kursimeve pensionale apo vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës janë dëshmi mbështetëse siç është thënë në Aktvendimin me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, e cila ka theksuar se: "dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmoohen me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatinin në të Ardhurat Personale".

Kandidatja T.D, me rastin e aplikimit për këtë pozitë ka dorëzuar dokumentacionin e përgatitjes profesionale respektivisht sipas Diplomës me Nr. 475 të datës 20.09.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", me të cilën dëshmohet se më datë 17.09.2018 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marrë titullin *Bachelor në Juridik*, ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta ka dorëzuar Certifikatën e datës 18.02.2020 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktiken një (1) vjeçare prej datës 01.03.2019 deri më datë 28.02.2020, sipas Letër Rekomandimit të lëshuar nga Komuna e Prizrenit e njëjta nga data 01.03-31.03.2021 ka qenë e angazhuar si praktikante në Drejtorinë Komunale të Arsimit, sipas Kontratës së Shërbimit të lidhur me "*Democracy Plus*" e njëjta nga data 23.09.2021 deri më datë 29.10.2021 ka qenë e angazhuar si anketuese, sipas Kontratës së Punës e njëjta nga data 01.07.2022 deri më datë 01.07.2023 ka qenë e angazhuar si Bashkëpunëtoreshë Profesionale në Zyrën e Avokatisë B. M SH.P.K ku për këtë përvojë të punës ka bashkëpunuar dëshmi nga pasqyra e kursimeve pensionale vetëm për muajin korrik, gusht dhe shtator 2022, sipas Marrëveshjes për punë praktike e lidhur me DEXIS nga data 19.09.2022 deri më datë 18.03.2023 ka qenë e angazhuar si praktikante e që rezultoi se këtë praktikë e ka në të njëjtën periudhë kohore kur ka qenë e angazhuar edhe në zyrën e Avokatit, ndërsa sa i përket përvojës së punës në Zyrën e Avokatisë B.M SH.P.K nga data 01.07.2022 deri më datë 01.07.2023, Kolegji i Këshillit konstaton se kjo është përvojë punë në një institucion privat dhe në bazë të dëshmive me pagesa nga kursimet pensionale e ka të mbuluar vetëm për muajt korrik, gusht dhe shtator 2022, kështu që referuar Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, kjo kandidatë nuk ka arritur të mbulojë këtë dëshmi të përvojës së punës me dëshmi nga institucionet përkatëse

Kandidatja K.K, me rastin e aplikimit për këtë pozitë ka dorëzuar dokumentacionin e përgatitjes profesionale respektivisht sipas Diplomës me Nr. 5008 të datës 26.10.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se më datë 09.09.2017 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marrë titullin *Jurist i Diplomuar-Bachelor*, ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta ka dorëzuar Certifikatën AGJ.nr.88/19 të datës 12.02.2019 të lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktiken një (1) vjeçare prej datës 13.02.2018 deri më datë 12.02.2019, sipas Kontratës së Shërbimeve të lidhura me Grupin për Studime Juridike dhe Politike rezultoi se e njëjta ka qenë e angazhuar si praktikante nga data 18.03.2019 deri më datën 17.09.2019, sipas Letër referencës së datës 05.01.2023 e njëjta ka qenë duke kryer punën praktike në Zyrën e Punësimit në Prishtinë nga data 05.04.2022 deri më datë 04.04.2023, që nënkuptohet se mbi bazë të shkresave të lëndës konstatohet se të njëjtës i është llogaritur puna praktike si përvojë pune në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, e që kjo dispozitë më specifikisht do të sqarohet më poshtë në arsyetim të këtij vendimi.

Kandidatja E.G, me rastin e aplikimit për këtë pozitë ka dorëzuar dokumentacionin e përgatitjes profesionale respektivisht sipas Diplomës të datës 29.11.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se më datë 10.09.2020 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marrë titullin *Jurist i Diplomuar-Bachelor*, ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta ka dorëzuar Certifikatën Nr. 174/22 të datës

18.02.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktiken një (1) vjeçare prej datës 23.02.2021 deri më datë 22.02.2022, sipas Letër referencës së datës 11.03.2021 të lëshuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë me të cilën nga muaji korrik deri në dhjetor të vitit 2019 ka qenë e angazhuar në cilësinë e praktikantes, sipas Vërtetimit të lëshuar nga "COSMOS TRAVEL" e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune nga data 01.03.2022 deri më datë 01.03.2023, ndërsa sa i përket përvojës së punës në "COSMOS TRAVEL" nga data nga data 01.03.2022 deri më datë 01.03.2023, Kolegji i Këshillit konstaton se kjo është përvojë punë në një institucion privat dhe nuk ka dorëzuar asnjë vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës si dokument mbështetës i kësaj përvojë.

Lidhur me dëshmitë e ofruar nga këta kandidatë për praktikë qoftë nëpër gjykata apo institucione të tjera e që sipas të cekurave më lartë kanë rezultuar që për disa kandidat këto praktika kanë qenë në një kohëzgjatje me të gjatë se një (1) vit, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, është përcaktuar se: "4. Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj", si rrjedhojë praktika e këtyre kandidatëve mund të merret si përvojë pune vetëm ajo praktikë e cila është për një periudhë një (1) vjeçare).

Ndërsa sa i përket përvojës së punës së kandidatëve në institucionet private, Kolegji i Këshillit referuar Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, e cila ka theksuar se dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmohen me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, konstaton se përvoja e punës në institucionet private duhet të mbështetet me dokumentet përkatëse nga këto institucione.

Nga konstatimet si më sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.19/2022 të datës 22.06.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, prandaj mbi këtë bazë i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet e lartcekura, konstaton se për shkak të shkeljeve ligjore të cekura si më lartë në këtë procedurë, atëherë me qëllim të eliminimit të tyre, Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është i obliguar të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të zhvilloj procedurën e rekrutimit për pozitën *Referent 6-gjashtë pozita në Gjykatën Komerciale*, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë dhe të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve duke u bazuar në konstatimet si më lartë dhe gjithëherë në respektim të normave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së

Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe dispozitave tjera ligjore që ndërlidhen me procesin e regrutimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1008/2023, datë 31/08/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së